

KONTRATË DHURIMI TË KUOTAVE TË SHOQËRISË

Më 29.06.2020 në selinë e Shoqërisë "Huhet" shpk, e regjistruar në QKR (Qendra Kombëtare e Regjistrimit), me NIPT (Numri Identifikues i Personit të Tatuashëm) L52304014T, në prani të palëve përkatëse u hartua kjo Kontratë Dhurimi të Kuotave të Shoqërisë:

Pala – DHURUESE

Z. Pellicani Vito lindur në Itali, baues në Itali, shtetas italian, madhor, me zotësi të plotë juridike për të kuptuar dhe dëshiruar, i identifikuar me Kartën e Identitetit CA 31969BD ortak me 50% të kuotave të kompanisë "HUHET" SH.P.K., i dhuron pjesën prej 50 % të kuotave totale në zotërim të tij përfituesit.

Z. Pellicani Massimo lindur në Itali, baues në Itali, shtetas italian, madhor, me zotësi të plotë juridike për të kuptuar dhe dëshiruar, i identifikuar me Kartën e Identitetit 357795AA ortak me 50% të kuotave të kompanisë "HUHET" SH.P.K., i dhuron pjesën prej 50 % të kuotave totale në zotërim të tij përfituesit.

Pala – PËRFITUESI

Znj. Majlinda Haloçi lindur në Shqipëri, banuese në Shqipëri, shtetase shqiptare, madhore dhe me zotësi të plota juridike për të kuptuar dhe dëshiruar ë identifikuar me ID H25614047H përfituese e 100% të kuotave të Shoqërisë.

Kjo kontratë nënshkruhet në përputhje me Ligjin nr. 9901, të datës 14/04/2008 "Për Shoqëritë Tregtare"; me Ligjin nr. 9723, të datës 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Shoqërive" dhe në bazë të Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë shpk, dhe Vendimin Nr. 3 të datës 12/07/2019 të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "HUHET" shpk.

OBJEKTI

Ortaku Pellicani Vito transferon 50% të pjesës takuese të kuotave të shoqërisë në zotërim të tij, me kalim përkatës në pronësi të Znj. Majlinda Haloçi.

Ortaku Pellicani Massimo transferon 50% të pjesës takuese të kuotave të shoqërisë në zotërim të tij, me kalim përkatës në pronësi të Znj. Majlinda Haloçi.

Në përputhje me Vendimin Nr. 03 të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "HUHET" shpk, hartohet, në prani të palëve të interesuara, Kontrata e Dhurimit të Kuotave të Shoqërisë.

Si konkluzion të Aktit të Dhurimit të Kuotave të Shoqërisë dhe depozitimit të këtij akti pranë QKR-së, Tiranë, pjesëmarrja në kapitalin e Shoqërisë "HUHET" shpk pëson këto ndryshime:

- Z. Pellicani Vito nuk është më Ortak i shoqërisë "HUHET"
- Z. Pellicani Massimo nuk është më Ortak i shoqërisë "HUHET"

HUHET SH.P.K.
NIPT L52304014T
TIRANA ALBANIA

- Znj. Majlinda Haloçi, pas transferimit të kuotave të shoqërisë në emrin e saj dhe kryerjes së regjistrimeve dhe ndryshimeve të duhura pranë QKR, bëhet pronare e pjesës presj 100% të kuotave të shoqërisë HUHET shpk.
- Administratori i Shoqërisë HUHET emërohet Znj. Majlinda Haloçi për një vit.
- Largohet si administratori i shoqërisë Z. Vitto Pellicani

Kjo kontratë Dhurimi të Kuotave të Shoqërisë u hartua në dy faqe dhe në katër kopje me vlerë juridike të njëjtë, dhe u lexua në prezencë të palëve të interesuara me zë të lartë, të cilët e konsideruan besnik të vullnetit të shprehur dhe me liri të plotë veprimi sipas Ligjit në fuqi, u nënshkrua nga palët në prezencë të të interesuarve.


Ky dokument deozitohet pranë QKR dhe vendoset te të dhënat e regjistrimit të shoqërisë HUHET shpk, dhe pasqyrohen ndryshimet e bëra te Struktura e Shoqërisë.

DHURUESI

Pellicani Vito



Pellicani Massimo



HUHET SH.P.K.
NIPT L52304014T
TIRANA ALBIA

PËRFITUESI

Majlinda Haloçi

